

POLITIKA E PËRGJITHSHME E SIGURISË

1. SIGURIA- POLITIKA E PËRGJITHSHME

Sigurimi i kushteve të sigurta të punës dhe mbajtja e vijimësisë së punës kanë një rëndësi thelbësore. Në këtë kontekst është e rëndësishme që politika dhe procedurat e duhura të zhvillohen me qëllim pasjen e sigurisë, eficiencës në kushtet e veprimit, me qëllim ruajtjen e punonjësve dhe lehtësimin e tyre.

Në kompani nuk do të lejohen të ekzistojnë kushte të pasigurta pune, si dhe nuk do të lejohet të kryehn veprime të pasigurta teknikisht. Shkelësit e rregullave të sigurisë do të jenë subjekt i masave disiplinore.

Kompania beson që punonjësit e sigurt dhe prona fizike e sigurt do të sigurojnë një program pune të drejtë dhe të kuptimtë.

a. Punonjësi

Duke qenë se zakonisht në ambjentet e punës punonjësit janë më të pasigurtë se çdo kush tjetër, punonjësit inkurajohen të rekomandojnë, sugjerojnë dhe kritikojnë kushtet jot ë sigurta tek mbikqyrësi i tyre direct me qëllim korrektimin dhe marrjen e masave.

b. Mbikqyrësit

Mbikqyrësit janë përgjegjës për kushtet e punës në departamentin e tyre dhe ambientin në përgjithësi. Një mbikqyrës duhet të jetë i kujdesshëm gjatë gjithë kohës për kushtet e rrezikshme dhe të pasigurta me qëllim rekomandimin e veprimeve korrektuese, të ndëshkojnë dhe dispijlojnë punonjësit që zakonisht krijojnë apo përdorin praktika të pasigurta, aksesojnë ose ndryshojnë veprimet e tyre në sitata rreziku si dhe të ndjekin sugjerimet e punonjësve për rregullimin e situatës me qëllim mënjanimin e kushteve të rrezikshme.

2. TAKIME TË KOMITETIT TË SIGURISË

Kompania vepron në përputhje me kodin, udhëzimet që ajo ka për të inkurajuar përfshirjen e punonjësve në komitetin e sigurisë së kompanisë dhe takimeve të tij që mbahen çdo 3 muaj. Komiteti do të specifikojë procedurat dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rast zjarri, sigurie dhe emrgjencash të tjera. Vendimet dhe rekomandimet duhet të komunikohen në takimet e departamenteve dhe mbledhjet e tyre.

3. DËMTIMET

Të gjithë punonjësit duhet të raportojnë të gjithë sëmundjet e shkaktuara nga puna apo dëmtimet e tyre pranë mbikqyrësit, pavarësisht sa i lehtë apo i rëndë është dëmtimi dhe të plotësojnë formularin në rast dëmtimi në punë.